

URDHËR
Nr. 726, datë 22.12.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për nënshkrimin e dokumentacionit të klasifikuar, nga data 22.12.2025 deri në plotësimin e detyrimeve ligjore për njohjen me informacionin e klasifikuar, tek zëvendësministri i Drejtësisë, z. Tedi Dobi.
 2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Tedi Dobi, për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Besfort Lamallari